



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Zyra e Kryeministrit - Ured Premijera - Office of the Prime Minister

Datë: 15.05.2020

Ref: 197/2020

I nderuar Drejtor i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës, z. Rashit Qalaj,

Sëmundja COVID-19 ka qenë ndër krizat më të mëdha shëndetësore që ka përjetuar vendi ynë ndonjëherë. Sot bëhen dy muaj nga shpallja e emergjencës për shëndetin publik pasi që mbërriti virusi në Kosovë, dhe po ashtu janë bërë 100 ditët prej formimit të qeverisë.

Dua ta shfrytëzoj këtë ditë për t'ju shprehur mirënjohjen time për kontributin e pazëvendësueshëm të Policisë së Kosovës në parandalimin e shpërndarjes së virusit. Policia është vendimtare në zbatimin e masave të qeverisë, në mbrojtjen e shëndetit publik dhe në mbrojtjen e sigurisë së qytetarëve gjatë kësaj krize.

Javët në vijim janë të rëndësishme për të përmirësuar gjendjen në Kosovë në lidhje me sëmundjen COVID-19. Ndonëse jemi krenarë me rënien e dukshme në numrin e infektiveve, virusi ende është në mesin tonë, ndaj kjo betejë nuk ka mund të konsiderohet aspak si e përfunduar. Nevojitet angazhimi i vazhdueshëm i institucioneve qendrore dhe komunale për ta mposhtur atë deri në fund, dhe posaçërisht angazhimi i zyrtarëve policor. Me relaksim të ngutshëm dhe të parakohshëm do të ndodhin infektive të reja, dhe kjo me të vërtetë se do të ishte shumë zhgënjyese për të gjithë. Me sukses në beteja të tilla rritet respekti për institucionet.

Kemi përgjegjësi të ndryshme, por ndajmë qëllimin e përbashkët në mbrojtjen e jetës së qytetarëve. Suksesi jonë do të matet me numrin e jetëve që do të shpëtojmë. Ky është misioni ynë.

Unë ju falënderoj për punën, përkushtimin dhe profesionalizmin e dëftuar gjatë pandemisë së sëmundjes COVID-19. Të jeni të sigurtë se sakrificat juaja vlerësohet lart nga të gjithë qytetarët e Kosovës.

Me respekt,

Albin Kurti

Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës